

UDHËZIM
Nr.12, datë 30.3.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE PLOTËSIME NË UDHËZIMIN “PËR TARIFAT E LEJIMIT, REGJISTRIMIT DHE PAGESAT E VERIFIKIMIT DHE KALIBRIMIT TË MJETEVE MATËSE DHE RREGULLAT E ZBATIMIT TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 15 të ligjit nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, Ministria e Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin “Për tarifën e lejimit, regjistrimit dhe pagesat e verifikimit dhe kalibrimit të mjeteve matëse dhe rregullat e zbatimit të tyre”(komunikuar kësaj drejtorie me shkresën nr.2135, datë 8.5.2003 për shkak se ky udhëzim në botim ka dalë pa numër dhe datë, vetëm me emërtim) të bëhen ndryshimet dhe plotësimet si më poshtë:

1. Pika 7, nënpika a, germa “i” dhe “ii” ndryshohen si më poshtë:

Për peshoret hekurudhore, automobilistike dhe ato me platformë për transportin e bazës etalonuese:

- Për largësi të vendndodhjes së peshores, që verifikohet deri në 45 km nga DPMK, shpenzimet shtesë merren në vlerën fikse 5000 lekë.

- Për largësi të vendndodhjes së peshores mbi 45 km, shpenzimet shtesë përcaktohen nga produkti i largësisë në km së vendndodhjes së saj nga DPMK, me tarifën 110 lekë/km.

2. Pika 17 ndryshohet si vijon:

Për kryerjen e aktiviteteve verifikuese dhe kalibruuese të pakryera me parë lejohet të punohet me tarifa provizore të përcaktuara nga DPMK-ja ; DPMK brenda 6 muajve nga aplikimi i tarifës kërkon miratimin e saj në Ministrinë e Financave.

3. Germa “b” e pikës 2 në pasqyrën nr.1, fjalja “ Për çdo grup prej 5 mjeteve matëse paguhet 10% e çmimit të blerjes së një mjeti” ndryshohet si vijon:

- Për mostra mjeteve matëse 10 000 lekë

4. Pika 6.6 në pasqyrën 3 ndryshohet:

Gjatë procesit të kalibrimit të enëve volumore, autoboteve, autocisternave dhe rezervuarëve paguhet tarifa e mëposhtme sipas volumeve:

- Kapaciteti 2000 m³, tarifa bazë 600 000 lekë

- Për çdo ulje kapaciteti me 500 m³ nga 2000 m³,
do të bëhet një ulje e tarifës bazë me 20 000 lekë

- Për çdo shtesë me 1000 m³ mbi kapacitetin
2000 m³, do të bëhet një rritje e tarifës
bazë me 40 000 lekë

- Për kapacitete nën 500 m³ do të bëhet pagesa
për çdo nënndarje 10 cm në vlerën 6500 lekë.

- Kur një subjekt në të njëjtën kohë kërkon që të kalibrojë disa rezervuarë, autocisterna, autobotë apo enë volumore që ndodhen në të njëjtin vend, tarifa për mjetin e parë do të merret e plotë, ndërsa për të tjerët do të merret 0.8 e tarifës përkatëse.

5. Në pikën 10.2 bëhen këto ndryshime:

Kufiri - mbi 1 kg deri 10 kg bëhet: mbi 1 kg deri 15 kg

Kufiri - mbi 10 kg deri 100 kg bëhet: mbi 15 kg deri 100 kg

6. Në pikën 10.3 bëhen këto ndryshime:

Kufiri - mbi 1 kg deri 10 kg bëhet: mbi 1 kg deri 15 kg
Kufiri-mbi 10 kg deri 50 kg bëhet: mbi 15 kg deri 50 kg

7. Në pasqyrën nr.3 shtohen pikat:

1.6 Komperator	3000 lekë
1.7 Kalibër	3000 lekë
1.8 Mikrometër	3000 lekë
19.3 Termometra me zhivë	2000 lekë

8. Nga pasqyra nr.3 hiqet pika nr.10.6.

9. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj